

VENDIM
Nr. 817, datë 29.12.2017

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 607, DATË 27.10.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KALIMIN E MJEDISEVE TË NDËRTESES “GODINA E INOVACIONIT” NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË AGJENCISË KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË INFORMACIONIT (AKSHI)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 607, datë 27.10.2017, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikën 2 bëhen këto ndryshime:

- Emërtimi “Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK)” zëvendësohet me “Agjencisë së Prokurimit Publik (APP)”.

- Pas paragrafit të parë të kësaj pike shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK) t’i jepen në përdorim mjediset në katin e dytë të godinës së inovacionit, sipas planimetrisë të dhënë në shtojcën 1/3 që i bashkëlidhet këtij vendimi, për ushtrimin e veprimtarisë së tij administrative.”.

b) Pika 4 shfuqizohet.

c) Në pikën 5, pas fjalëve “... Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG)... ” të shtohen fjalët “... dhe Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI)...”.

2. Vendimet e Këshillit të Ministrave, nr. 12, datë 16.1.2013, “Për kalimin në përdorim të Agjencisë së Prokurimit Publik të disa mjediseve në përdorim të Komisionit të Prokurimit Publik dhe kalimin në përdorim të Komisionit të Prokurimit Publik të disa mjediseve të ndërtesës (godinës) së ish-INIMA-s” dhe nr. 237, datë 7.4.2010, “Për dhënien në përdorim Komisionit të Prokurimit Publik të disa mjediseve, në administrim të Agjencisë së Prokurimit Publik”, shfuqizohen.

3. Ngarkohen Kryeministria, Ministria e Brendshme, Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik, Agjencia e Prokurimit Publik, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

